



BASHKIA GRAMSH

RELACION TEKNIK

Nr. 4560 Prot.

Gramsh më, 18/10 /2024

**“RIKONSTRUKSIONI I OBJEKTIT ISH HOTEL DEVOLLI, NË LAGJEN
HOLTA BASHKIA GRAMSH”**




TETOR -2024-

Të përgjithshme

Bashkia Gramsh kërkon të realizojë rikonstruksionin e objektit ish hotel Devolli. Objekti në fjalë është dy katësh. Ky objekt rezulton me katin përdhe të privatizuar nga individë të ndryshëm të cilët e kanë përshtur për biznes, ndërsa kati i parë është në pronësi të Bashkisë së Gramshit me nr. pasurie 7/167-N18, zonë kadastrale 1842 dhe me sipërfaqe totale të ndërtesës 235.42 m². Objekti pozicionohet në anën perëndimore të Bashkisë dhe me një distancë prej afro 100 m nga qendra e qytetit. Objekti në fjalë ish hotel Devolli gjendet në koordinata : 40 52 07.47 N dhe 20 10 59.81 E. Përsa i përket historikut ky objekt është ndërtuar rreth viteve 1950 dhe siç e theksuam është objekt 2 katësh. Funkzioni i tij ndër vite apo i mëparshëm ka qenë hotel restorant, ku përkatesisht në katin përdhe ka qenë i implementuar restoranti dhe në katin e parë hoteli. Duhet theksuar se ky objekt ka pasur një rol të veçantë dhe të rëndësishëm për kohën kur është ndërtuar dhe veprimtarinë e tij në vazhdimësi.

Planimetria ekzistuese



druri,gjithashtu duhet theksuar se ky objekt nuk ka patur dhe nuk ka suvatim të jashtëm,por ka qenë i lyer me gëlqere.

Ish hotel Devolli, objekt i këtij relacioni nuk ka pësuar asnjëherë rikonstruksion që nga koha e ndërtimit të tij. Ambienti përreth ketij objekti paraqitet i sistemuar.

Për sa më sipër grupi i punës konkludon se ky objekt është tepër i amortizuar dhe propozon që të ndërhyhet në mënyrë të menjëhershme,pasi gjendja aktuale nuk krijon siguri për çfarëdo lloj funksioni që mund të përshtatet.



TETOR -2024-



TETOR -2024-




Vizioni i Bashkisë Gramsh pas rikonstruksionit të objektit ish hotel Devolli.

Bashkia e Gramshit mendon që me këtë investim, këtij objekti do ti kthejë edhe njëherë funksionalitetin e dikurshëm. Pas rikonstruksionit ky objekt do të kthehet në një hotel publik nën administrimin e Bashkisë Gramsh, ku do ti shërbejë jo vetëm qytetarëve të vet, por edhe turistëve pasi qyteti i Gramshit ka një potencial të madh dhe aktiv të aktraksionit turistik. Përveç kësaj pas rikonstruksionit, objekti ish hotel Devolli do të harmonizohet edhe me arkitekturën e objekteve përreth dhe do ti japë qytetit një kualitet në raport me kategorinë e objekteve të kohës së sotme.

TETOR -2024-



TETOR -2024-



TETOR -2024-

Rikonstruksioni i këtij objekti do të çojë edhe në përmisimin e sigurisë së vet ne lidhje me strukturën nga njëra ana dhe nga ana tjetër do të përmbushë objektivat dhe politikat e Bashkisë së Gramshit.

Relatoi :

Ing. Orgent Çoniku



MIRATOHET :

KRYETARI

BESION AJAZI

